



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERGJETIKES
DREJTORIA E PERGJITHSHME E PATENTAVE DHE MARKAVE

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2010



TË DHËNAT U PËRGATITEN NGA DPPM
TIRANË, Janar 2011,

PËRMBAJTJA

I-AKTIVITETE TË DREJTORISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E ANGAZHIMEVE NË KUADËR TË MSA-SË.....

II-DETYRAT FUNKSIONALE TË REALIZUARA SIPAS SEKTORËVE.....

1- SEKTORI I EKZAMINIMIT TË PATENTAVE DHE MODELEVE TE PERDORIMIT....

2- SEKTORI I EKZAMINIMIT TË MARKAVE DISENJOVE DHE TREGUESVE GJEOGRAFIKE.....

3- SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË.....

4-SEKTORI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT.....

5- SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, SHËRBIMEVE DHE FINANCËS.....

I. AKTIVITETE TË DREJTORISË NË LIDHJE ME ZBATIMIN E ANGAZHIMEVE NË KUADËR TË MSA-SË

DPPM, për vitin 2010, ka realizuar të gjitha detyrat funksionale të ngarkuara si dhe ka përafruar plotësisht legjislacionin shqiptar në fushën e Pronësisë Industriale me atë të vendeve të BE. Në vijim të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga MSA, DPPM ka ndërmarrë iniciativa të mëtejshme ligjore dhe ka përmbushur një sërë aktiviteteve zbatuese si më poshtë:

1. Iniciativa ligjore në kuadër të MSA

a. Anëtarësimi në Marrëveshje Ndërkombëtare në fushën e PI

Neni 73 i MSA si dhe Aneksi V i kësaj marrëveshje parashikon detyrimin e shtetit shqiptar për t'u antarësuar në një numër marrëveshjesh ndërkombëtare në fushën e Pronësisë Industriale, brenda katër vjetëve nga hyrja në fuqi e MSA-së. Në zbatim të këtij detyrimi, gjatë vitit 2009, DPPM ka qenë në krye të iniciativës ligjore për aderimin e Shqipërisë në dy marrëveshjet e fundit ndërkombëtare në fushën e PI të parashikuara në listën e Aneksit V të MSA: Konventën Evropiane të Patentave dhe Marrëveshjen për të Drejtën e Patentave administruar nga WIPO, iniciativë e cila është finalizuar me aprovimin nga parlamenti shqiptar të ligjeve të mëposhtëm:

- Ligji Nr. 10179 datë 29.10.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Patentave". Parlamenti shqiptar aprovoi me ligjin Nr. 10179 datë 29.10.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Patentave" hyrjen e Shqipërisë në Zyrën Evropiane të Patentave.

Ky ligj u dekretua me dekretin e Presidentit të Republikës Nr. 6338 datë 17.11.2009. Në 1 Maj 2010, pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje,

Shqipëria bëhet vendi i 37 anëtar i Organizatës Evropiane të Patentave.

Me anëtarësimin në Zyrën Evropiane të Patentave, Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave, bëhet anëtare në një nga institucionet më të specializuara në lidhje me patentat sic është Zyra Evropiane e Patentave.

Patentat Europiane të shpikjeve janë tashmë të vlefshme në mbi 40 vende dhe përfshijnë një treg me rreze veprimi prej rreth 570 milion njerëz.

Zyra Europiane e Patentave aplikon një procedurë të centralizuar për të ekzaminuar aplikimet për patentë Europiane për vendet anëtare. Nëpërmjet një aplikimi të vetëm aplikantët mund të sigurojnë mbrojtjen e patentës së tyre në vendet anëtare dhe në vendet e shtrirjes që ato vetë përcaktojnë.

- Ligji Nr.10180 datë 29.10.2009 " Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen për të Drejtën e Patentave të WIPO". Në 17 shkurt 2010 Qeveria e Republikës së Shqipërisë depozitoi instrumentat për aderimin e Shqipërisë në Marrëveshjen për të Drejtën e Patentave të WIPO. Marrëveshja e lartpërmendur hyri në fuqi në lidhje me Republikën e Shqipërisë në 17 Maj 2010.

Ratifikimi i këtyre dy marrëveshjeve dhe anëtaresimi në Organizaten Europiane të Patentave shënon dhe përfundimin e Iniciativave Ligjore të parashikuara në PKZMSA si dhe në Aneksin V të MSA-së.

b- Hartimi i Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale

Një nga detyrat e MSA dhe një nga rekomandimet e Progress Raporteve të BE-së 2008, për vitin 2009 - 2010 është hartimi i Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale. Në kuadër të zbatimit të këtij angazhimi, në Mars 2009 me mbështetjen e Ministrisë së Integrimit Europian, është ngritur një grup ndërministror i përbashkët në përbërje të të cilit janë DPPM, ZSHDA, Doganat, Policia Tatimore, Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore dhe Policia e Krimin Ekonomik. Ky grup pune i krijuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 40 dt. 18.03.2009 gjatë muajit Mars 2009 është mbledhur në takime të përbashkëta pune në mënyrë periodike nën kryesimin e Zv/Ministrit të Integrimit Europian.

Në kuadër të projektit IPA Rajonale 2007, DPPM ka kërkuar asistencë nga Zyra Evropiane e Patentave për kryerjen e një vlerësimi të sistemit të zbatimit të të drejtave të PI në Shqipëri, si hapi i parë për përgatitjen e një draft strategjie. Gjatë periudhës Janar-Gusht 2010 janë zhvilluar takime të mëtejshme të grupit ndërinstitutional, ekspertëve të EPO-s dhe ekspertëve shqiptarë për formatin e strategjive dhe, duke u marrë në konsideratë edhe rekomandimet e mbledhjes së datës 29 Prill 2010 të nënkomitetit BE-Shqipëri, u hartua drafti përfundimtar i

Strategjisë. Ky draft pasi u shqyrtua nga komisionet parlamentare gjatë muajit Korrik 2010 iu dërgua për aprovim Këshillit të Ministrave.

Ky draft i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2010 – 2015 u aprovua **me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 760, datë 01.09.2010.**

c. Pyetësi i Bashkimit Europian

Në kuadër të integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian si dhe depozitimit të kërkesës së Qeverisë Shqiptare për marrjen e statusit të vendit kandidat në muajin Dhjetor 2009 është dorëzuar Pyetësi i Komisionit Europian. Në 11 Dhjetor 2009 është ngritur një Grup Punë i DPPM që ka qenë pjesë e një grupi ndër-institucional pune i përbërë nga përfaqësues nga të gjitha institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të PI. Në fund të muajit Dhjetor 2009 është përfunduar drafti i përgjigjeve të pyetësit i cili iu dorëzua Komisionit Evropian në muajin Prill 2010.

Pas dorëzimit të Kapitullit VII të Pyetësit, gjatë muajit Qershor 2010 janë përgatitur 19 përgjigjet e pyetjeve shtesë në lidhje me këtë kapitull të cilat janë dorëzuar më datë 10 Qershor 2010 në Ministrinë e Integritit në Anglisht dhe në Shqip, së bashku me dy anekset e kërkuara për këtë Kapitull.

d. Përgatitja e projekt-akteve ligjore në fushën e Pronësisë Industriale:

Gjatë muajit shtator 2010, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e Pronësisë Industriale, janë përgatitur draftet e ndryshimeve së bashku me relacionet shpjeguese për këto akte nënligjore: VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 “Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale”, VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, Urdhërit Nr. 406 datë 06.05.2009 “Për miratimin e rregullores së brendshme të DPPM”.

DPPM ka dhënë mendim lidhur me projekt vendimin “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 463 datë 05.07.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, të ndryshuar.

Gjithashtu është përgatitur dhe marrëveshja e bashkëpunimit mes DPPM dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe plani i veprimit për forcimin e infrastrukturës së IT dhe krijimin e Qendrave të Informacionit me asistencën e WIPO-s. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar më 07 Tetor 2010.

Në kuadër të monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale për parandalimin, luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjen transparente, gjatë muajit Shtator 2010 është përgatitur raporti i arritjeve antikorrupsion për vitet 2005-2010 për DPPM.

e- Përkthimi i klasifikimit Ndërkombëtar të Nicës, Locarnos, IPC (klasifikatori i patentave).

Në kuadër të projektit IPA Rajonale 2007 janë përkthyer edicioni i 9 i klasifikimit të Nicës për klasat e mallrave dhe shërbimeve, klasifikimi i Locarnos si dhe i klasifikimi i Vienës. Këto klasifikime janë kthyer në format elektronik dhe janë hedhur në faqen e internetit të DPPM dhe janë bërë të aksesueshme.

Me përkthimin e tyre plotësohet një nga iniciativat ligjore afat shkurtra të ndërmara në kuadër të zbatimit të planit të PKZMSA.

2- Aktivitete zbatuese

a- Nënshkrimi i protokollit të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

Gjatë muajit shtator 2010, specialistët e DPPM në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, hartuan draftin final të Memorandumit të Bashkëpunimit midis dy institucioneve i cili u nënshkrua më **18 Tetor 2010**.

b- Promovimi dhe rritja e sensibilizimit për çështje të PI mes bashkësisë së biznesit dhe institucioneve në zbatim të ligjit duke përfshirë institucionet dhe operatorët ekonomik.

- Në kuadër të Programit Rajonal mbi të Drejtat e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, Zyra Europiane e Patentave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave , organizoi Seminarin mbi Sistemin Europian të Patentave. Seminari u zhvillua në Hotel Tirana, më 1 Qershor 2010. DPPM u paraqit me një prezantim me temë “Roli i DPPM në mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale në Shqipëri”

- Më datë 3 Qershor 2010 përfaqësues të DPPM morën pjesë në workshopin e organizuar nga DIHA (Shoqata Gjermane e Industrisë dhe Tregtisë në Shqipëri) me temë “Konkurrenca e pandershme në tregun e automjeteve dhe pjesëve të këmbimit”. Në këtë workshop merrnin pjesë edhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave si dhe përfaqësues të qarqeve të biznesit dhe studiove ligjore që operojnë në fushën e PI. DPPM me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e bizneseve shqiptare të cilat kanë kontrata marrëveshjesh bashkëpunimi me kompanitë e mëdha të prodhimit të automjeteve në Evropë, paraqiti një prezantim lidhur me sistemin e regjistrimit dhe mbrojtjes së të drejtave mbi markat tregtare në Shqipëri.

- Nga data 5-7 Maj 2010, përfaqësues të DPPM morën pjesë në workshopin me temë: “Biznesi i vogël dhe i mesëm (SME) në kohën e krisës globale”, organizuar nga Organizata e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi dhe KONRAD-ADENAUER-SIFTUNG ANKARA (KAS) në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Në këtë workshop u diskutuan tema si: “ Iniciativa për kompanitë e vogla e të mesme në krijimin e një mjedisi ekonomik të favorshëm për të zbutur impaktin e krizës ekonomike”; “ Situata Ekonomike në Europën Juglindore me fokus impaktin e krizës në SME”; “ Mbështetja dhe promovimi për krijimin dhe zhvillimin e SME-ve”.

- Më datë 23 qershor 2010, Dhoma Amerikane e Tregtisë në Shqipëri zhvilloi një forum biznesi me temë “Politikat dhe Strategjitë e Institucioneve të Mbrojtjes së të Drejtave të Pronësisë Intelektuale”. Në këtë forum morën pjesë përfaqësues të DPPM, përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit.

- Në datat 27 dhe 28 Tetor 2010 në Tiranë, në ambientet e Hotel Mondial, Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit së bashku me Drejtorinë e Përgjithshme të Markave dhe Patentave (DPMP) dhe me Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO), të organizuan një Trajnim 2-ditor për Gjykatës, Prokurorë dhe Avokatë për forcimin e zbatimit të të drejtave të Pronësisë Intelektuale. Në takim u diskutua në lidhje me fallsifikimin e produkteve, mbi shkeljen e të drejtave të PI, zbatimin e këtyre të drejtave (marrëveshja e Tripsit), mbi rolin e mbajtësit të të drejtave, dhe rolin e gjykatës në zbatimin e këtyre të drejtave dhe mbi shkatërrimin e mallrave të fallsifikuara. DPPM u paraqiti në takim me një prezantim me temë: “Roli i DPPM në zbatimin e të drejtave në fushën e PI”.

- Programi rajonal mbi të drejtat e Pronësinë Industriale dhe Intelektuale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi në bashkëpunim me DPPM organizuan në datat 26-28 tetor 2010 në ambientet e hotel Tiranës konferencën rajonale mbi krimin në të drejtat e Pronësisë

Intelektuale. Në takim u prezantuan eksperiencat e rajonit të Ballkanit në lidhje me zbatimin e të drejtave të PI, u theksua nevoja e forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e PI.

DPPM u paraqit me një prezantim me temë “ Roli i DPPM në zbatimin e të drejtave të PI në Shqipëri”. Në takim morë pjesë përfaqësues të DPD, Prokurorisë dhe Gjykatës.-

c- Trajnimi i burimeve njerëzore te përfshira ne procesin e dhënies se te drejtave te pronësisë industriale nëpërmjet programeve te trajnimit te specialisteve, te përfaqësuesve te autorizuar si dhe te personave te çdo kategorie tjetër.

- Më datë 07 Qershor 2010, përfaqësues të DPPM morën pjesë në mbledhjen e radhës të Komitetit të EPO për Mbështetjen Teknike dhe Operacionale i zhvilluar në Mynih të Gjermanisë. Çështjet e diskutuara ka ky Komitet ishin:

- Progres raporti i kooperimit me vendet anëtare;
- Studime mbi sistemin Soprano;
- Aspektet themelore të politikave të kooperimit mes EPO dhe vendeve anëtare.

Ne menyre te vecante u diskutua mbi sistemin Soprano dhe perfeksionimin e tij si sistem netëorku qe lidh zyrat e Shteteve antare per shkembime informacioni ne fushen e patentave.

- Në kuadër të job-training, të shkëmbimit të eksperiencave me zyrat homologe përfaqësues të DPPM morën pjesë në Seminarin JS03, në Mynich :” Mbi procedurat e kundërshtimit dhe të apelit në EPO”, zhvilluar nga data 13-17 Qershor, organizuar nga Akademia Europiane e Patentave.

Ne kete seminar u trajtuan keto tematika:

- Zyra Europiane e Patentave, nje veshtrim i pergjithshem;
- Procedurat e dhenies se nje patente europiane;
- Perjashtimet nga patentimi;
- Analiza e hapit shpikes;
- Case Law;
- Efektet e nje aplikimi per patente europiane dhe qellimi i mbrojtjes sipas nenit 69 EPC;
- Kundërshtimet;
- Bordi i apelit;
- Harmonizimi ne interpretimin e Ligjit European mbi patentat nga gjykata nacionale dhe bordet e Apelit.

Në datat 5-7 Tetor 2010 u zhvillua në Tallinn të Estonisë një trajnim mbi konceptet themelore për orientimin e përdoruesve të faqeve të internetit përsa i përket patentave të shpikjeve, organizuar nga Akademia Europiane e Patentave.

Në takim morën pjesë përfaqësues të DPPM të prezantuan materialin me temë “ Një shikim i përgjithshëm mbi DPPM dhe në vecanti mbi organizimin e faqes së saj internetit.

- Gjatë vitit 2010 përfaqësues të DPPM kanë marrë pjesë në mbledhjet e rradhës të Steering Committee zhvilluar në Vienë të Austrisë për IPA Rajonale si dhe në mbledhjet e Komitetit dhe Asamblesë të Wipo dhe EPO-s.

c. Publikimet periodike të DPPM dhe faqja e internetit

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2010, DPPM ka publikuar Buletinin e Pronësisë Industriale i cili përmban informacione për publikun mbi aplikimet për patenta për shpikje, patenta të lëshuara, aplikimet për dizeno industriale, marka të depozituara, emërtime origjine të regjistruara, marka të regjistruara, marka të ripërtërira. Gjatë periudhës së raportimit janë publikuar numrat e mëposhtëm të Buletinit:

- Buletini Pronësisë Industriale Nr. 27 datë 12 Prill 2010 në të cilin janë publikuar 872 rekorde të objekteve të PI.

- Buletini Pronësisë Industriale Nr. 28 datë 08 Korrik 2010 në të cilin janë publikuar 755 rekorde të objekteve të PI.

- Buletini Pronësisë Industriale Nr. 29 datë 12 Tetor 2010 në të cilin janë publikuar 651 rekorde të objekteve të PI.

- Buletini Pronësisë Industriale Nr. 30 datë 27 Dhjetor 2010 në të cilin janë publikuar 513 rekorde të objekteve të PI.

Totali i rekordeve të publikuara gjatë vitit 2010 arrin në 2791 rekorde.

Faqja e internetit të DPPM, www.alpto.gov.al, është një burim i rëndësishëm informacioni për personat të cilët janë të interesuar të aplikojnë për regjistrimin e objekteve të PI. Nëpërmjet saj, DPPM informon publikun në lidhje me aktivitetet dhe shërbimet që ajo kryen, në lidhje me legjistracionin në fushën e PI, rreth objekteve të PI (patentat, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë).

Faqja e internetit përmban informacionin mbi mënyrën e aplikimit për secilin nga objektet e PI. Një aktivitet shumë i rëndësishëm i realizuar nga DPPM në 2010, në kuadër të rritjes së shërbimeve të ofruara nga DPPM sektori i TI ka pasur në fokus publikimim on line të të dhënave bibliografike të objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në Shqipëri. Për këtë qëllim ka hartuar planin për kerkesat drejtuar WIPO-s për ta

mundesuar kete sistem. Gjate 2010 sektori i TI mundesoni fillimisht publikimin e ketyre te dhenave ne format xls dhe ne fokusin e 2011 eshte publikimi ne nje forme me te pershtatshme.


Nëpërmjet faqes së internetit aplikuesit mund të hyjnë direkt në faqen e internetit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe të bëjnë kërkime on-line mbi markat e regjistruara nëpërmjet Marrëveshjes së Madridit.

III- DETYRAT FUNKSIONALE SIPAS SEKTOREVE

1. SEKTORI I EKZAMINIMIT TE PATENTAVE DHE MODELEVE TE PERDORIMIT.

Sektori i ekzaminimit të patentave dhe modeleve të përdorimit ka mbuluar të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë e cila ka të bëjë me regjistrimin dhe administrimin e patentave të shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.


Për patentat e shpikjeve në vitin 2010 numri i aplikimeve në total ka qenë **341** aplikime nga të cilat: **338** nga EPO, **1** aplikim PCT dhe **2** kombëtare .



Grafiku i mësipërm tregon numrin e aplikimeve për patentë shpikje të depozituar në DPPM nga viti 1993 deri në 2010

Tabela dhe grafiku i mëposhtme tregon fluksin e aplikimeve që kanë hyrë dhe kanë dalë nga sektori i patentave.

Aplikime/Patenta	Hyrje ne DPPM	Dalje nga DPPM
Aplikime për patentë	341	348 (grantime patentash)
Ndryshim pronësie /emri/adrese/pretendime	99	93(te pranuar)
Aplikime për ripertëritje	1851	1506 (te pranuar)
Aplikime për çertifikatë të mbrojtjes shtesë	6	3
Hetim patente	131	126 (te pranuar)



Gjatë vitit 2010 janë lëshuar **330** dëshmi depozitimi, janë lëshuar **58** njoftime për plotësim formalitetesh të aplikimeve për patenta, nga të cilat: **2** kërkesa janë refuzuar për t'u depozituar ,**10** janë refuzuar për t'u grantuar për mosplotësim të dokumentacionit në afatin e caktuar . Gjitashtu janë lëshuar 348 patenta për shpikje dhe një model përdorimi.

Janë egzaminuar dhe pranuar **1506** ripertëritje patentash ndërsa **203** patenta janë egzaminuar dhe u është dhënë statusi skaduar për arsye të mospagesës së tarifës përkatëse për ripertëritje të patentës .

Grafiku i mëposhtëm tregon volumin e punës nga sektori i patentave gjate ketij viti.





Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve për patenta dhe patentat e lëshuara në vitet 2000-2010.



Ndërkohë që numri i aplikimeve për patente për 2010 ka qenë **341** aplikime po gjatë këtij viti janë regjistruar **348** Patenta dhe një model përdorimi.

VITI	Aplikime për patenta	Patenta të lëshuara në këtë vit
2000	63	6
2001	120	49
2002	238	87
2003	392	201
2004	420	390
2005	386	395
2006	426	116
2007	367	420
2008	377	541
2009	361	402
2010	341	348

Gjithashtu janë shqyrtuar **8** raste për rivendosje në afat të patentave /aplikimeve për patente te cilat janë kthyer në jetë.

Gjate këtij viti është përballuar një volum i madh i pune dhe është pare një angazhim i madh nga ana e stafit për realizimin e detyrave të mara përsipër vitin e kaluar duke i realizuar ato plotësisht.

Gjatë vitit 2010 nga ky sektor është punuar dhe në drejtime të tjera si:


- 1- Trainimi i stafit për adaptimin me Konventën Europiane të Patentave dhe rregulloren e saj.
- 2- Janë hartuar progres raportet dhe statistikat mujore për objektet e PI
- 3- Stabilizimi i plotë i arkivës (pajisja me logjistikën përkatëse)
- 4- Paisja me bazë materiale dhe logjistike e Sektorit të Patentave
- 5- Stafi i sektorit ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me WIPO dhe EPO

Është dhënë kontribut në amendimin e rregullores për patentat .


2. SEKTORI I EKZAMINIMIT TE MARKAVE TREGTARE DHE TE SHERBIMIT, DIZENJOVE INDUSTRIALE DHE TREGUESEVE GJEOGRAFIKE

Sektori i ekzaminimit të markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë për vitin 2010 ka mbuluar të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë e cila ka të bëjë me regjistrimin e aplikimeve të objekteve të Pronësisë Industriale si markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë. Nga ky sektor lëshohen të gjitha ekstraktet e rregjistrimit dhe kryhen hetime sipas kërkesave të aplikuesve për të gjitha objektet e PI të lartpërmendura. Gjatë vitit 2010 janë depozituar 928 aplikime për marka nga të cilat 318 janë aplikime për ripërtëritje marke dhe janë lëshuar 866 certifikata regjistrimi marke nga të cilat 272 janë certifikata ripërteritje marke.

Në grafikun e mëposhtëm paraqitet numri i aplikimeve, regjistrimeve dhe ripërtëritjeve në vite.




Nëse do të krahasonim numrin e aplikimeve me numrin e regjistrimeve të kryera gjatë vitit 2010 aplikimet zënë (52%) dhe regjistrimet (48%).



Nga sektori i markave gjatë vitit 2010 janë lëshuar: 583 dëshmi depozitimi dhe janë publikuar; për 403 aplikime janë lëshuar njoftime për plotësim defektesh dhe formalitetesh, 590 ftesa për pagesë regjistrimi, janë ekzaminuar 190 aplikime për ndryshime ne pronësi dhe 347 ndryshime ne emër dhe adrese, janë lëshuar 594 certifikata regjistrimi, 272 certifikata regjistrimi ripërtëritje, dhe 7 dorëheqje nga marka.


Ne total gjate vitit 2010 nga ky sektor janë lëshuar 3591 dokumenta për markat tregtare dhe të shërbimit, dizenjot industriale dhe emërtimet e origjinës:


<i>Dokumenta të lëshuara në vitin 2010</i>	<i>Nr. dokumentave</i>
Deshmi depozitimi	583
Njoftim plot form	403
Ftesë për pagesë reg	590
Certif. Reg	594
Ripërtëritje marke	272
Ndryshim Ermri	242
Ndryshim Adrese	105
Ndryshim Pronari	190
Refuzime për mospagesë reg	8
Refuzim ne form exam	44
Refuzim ne baza absolute	7
Kufizim I listës së mallrave	12
Doreheqje marke	7
Dublikata	26
Hetim marke	299
Ekstrakt Regjistri	202
Licenca marke	7
TOTALI I DOKUMENTAVE TË LËSHUARA	3591



Sic shihet nga grafiku kemi nje balancim te punes se realizuar ne vitin 2009 ne krahasim me punen e realizuar ne vitin 2010.

Volumi më i madh i punës së këtij sektori është realizuar në drejtim të lëshimit të certifikatave të regjistrimit, ftesave për pagesë regjistrimi, lëshimit të dëshmive të depozitimit dhe dokumentave të lëshuara për ndryshim pronësie, adrese dhe emri. Grafiku i mëposhtëm tregon një pjesë të dokumentave të lëshuara gjatë procesit të ekzaminimit në vitin 2010.





Nëse do te krahasonim numrin e dokumentave të lëshuara në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009 do të vinim re se:

- Në vitin 2010 janë lëshuar 403 njoftime plotesim formalitetesh marke nga 559 njoftime të lëshuara në vitin 2009 gjë që tregon se nga ana e DPPM-së është bërë një punë shumë e mirë në drejtim të ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të autorizuar dhe subjekteve shqiptare në lidhje me mënyrën e paraqitjes dhe plotësimit të dokumentacionit. Plotësimi i saktë i dokumentacionit ndikon në eliminimin e lëshimit të njoftimeve për plotësim dokumentacioni, duke shpjetuar në këtë mënyrë procedurat për lëshimin e Çertifikatës së rregjistrimit. Kjo ka sjelle si pasije rritjen e numrit te ftesave per pagese rregjistrimi te leshuara nga DPPM gjate vitit 2010.

Gjatë këtij viti jemi përpjekur të minimizojmë kohën për zbatimin e procedurave administrative për markat, duke zbatuar me rigorozitet afatet ligjore. Qëllimi kryesor i punës është të sigurojmë cilësi të lartë dhe shërbime të shpejta për të gjithë aplikantët gjatë procesit të egzaminimit.

Në tabelën e mëposhtme jepen dokumentat e depozituara në DPPM gjatë vitit 2010.

DOKUMENTA TE DEPOZITUARA NE DPPM

Kërkesa për regjistrim marke	610
Kërkesa për ripërtëritje marke	318
Kërkesa për ndryshim i emrit te pronarit	188
Kërkesa për ndryshimin e adresës se pronarit	110
Kërkesë për kufizim të listës së mallrave	1
Kërkesa për ndryshim pronari	181
Kërkesë për ekstrakt regjistri	199
Kërkesë për doreheqje marke	8
Kërkesë për mos rregjistrimin e markes se publikuar	19
Kërkesë për licencë	21
Kërkesë për hetim marke	354

Regjistrat e objekteve të pronësisë industriale për sektorin janë azhornuar përkatësisht me 1535 fletë regjistri, janë vendosur fletët e regjistrit për 537 ndryshime emri, ndryshime adrese dhe ndryshime pronësie, janë vendosur fletët e regjistrit të 272 ripërtëritjeve si dhe janë marre ne dorëzim 1108 dosje.


Gjatë vitit 2010 i është dhënë përgjigje 299 kërkesave për hetim marke përfshirë këtu (hetim në regjistrat kombëtare dhe ndërkombëtare), janë lëshuar 202 ekstrakte regjistri dhe 26 publikata marke.

Aplikimet nga Marrëveshja e Madridit

Gjatë vitit 2010 janë rregjistruar 4029 aplikime nga Marrëveshja e Madridit nga të cilat 1233 janë aplikime për ripërtëritje markash.

Ne total në DPPM në vitin 2010 janë depozituar 4957 aplikime dhe ripërtëritje nga të cilat 4029 nga Marrëveshja e Madridit, 642 aplikime të huaja dhe 286 aplikime shqiptare. Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregojnë numrin e aplikimeve vendase, aplikimeve në rrugë kombëtare dhe aplikimeve nga Marrëveshja e Madridit, gjatë vitit 2010.

Viti	2010
Aplikime shqiptare	286
Aplikime ne rruge kombëtare nga aplikante te huaj	642
Aplikime nga Marrëveshja dhe Protokoli i Madridit	4029
TOTALI	4957



Sic shihet nga grafiku gjatë këtij viti kemi një rritje të aplikimeve shqiptare në krahasim me aplikimet e bëra një vit më parë.

Nga ky sektor janë hedhur në IPAS veprimet e firmosjes për 1438 aplikime kombëtare. Gjithashtu në këtë vit ka filluar hedhja në IPAS e veprimeve për aplikimet e ardhura nga Marrëveshja e Madridit duke hedhur në këtë mënyrë në sistem 784 veprime. Për korespondencat e Madridit nga 16-39 janë hedhur veprimet e kalimit në sistemin IPAS pasi bërë dhe ekzaminimet në baza absolute. Ndërsa korespondencat nga 40-49 nuk janë hedhur akoma për shkak të punës në përmirësimin e sistemit nga ana e sektorit të TI.

Gjatë vitit 2010 janë lëshuar 4 certifikata regjistrimi disenjosh industriale, 10 ripërtëritje disenjosh, 2 dëshmi depozitimi, 4 njoftime plotësim dokumentacioni, është bërë 1 refuzim disenjoje si dhe janë ekzaminuar dhe janë lëshuar 14 ndryshime në pronësi.

Në vitin 2010 janë depozituar 6 kërkesa për regjistrim disenjoje dhe 11 kërkesa për ripërtëritje disenjoje si dhe një kërkesë për regjistrim tregues gjeografik.

Gjate vitit 2010 nga ky sektor është punuar dhe në drejtime të tjera si:

- 1- Janë hartuar progres raportet mujore në lidhje me aktivitetin e DPPM në zbatim të angazhimeve të MSA si dhe janë hartuar raportet 6- mujore të punës dhe raportet javore punës.
- 2- Përfaqësues të këtij sektori kanë përfaqësuar DPPM në seminare të ndryshme ku dhe kanë diskutuar mbi legjislacionin e ri të DPPM-së, mbi markat dhe rëndësinë e tyre për ekonominë e tjerë.
- 3- Është sistemuar arkiva e markave dhe disenjove.
- 4- Stafi i sektorit ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme të organizuara në bashkëpunim me WIPO dhe EPO.

3- SEKTORI JURIDIK DHE I MARRËDHENIEVE ME JASHTË

Sektori Juridik i Marrëdhënieve me Jashtë dhe Trajnimeve gjatë vitit 2010 në përmbushje të detyrave të tij organike ka punuar në këto drejtime kryesore:

A. Ndjekja e procedurave dhe përpilimi i akteve ligjore për kërkesat e paraqitura pranë Bordit të Apelit të DPPM.

Gjatë vitit 2010, Sektori Juridik ka ndjekur procedurat dhe ka përgatitur njoftimet dhe aktet e tjera ligjore për **43 kërkesa** të paraqitura pranë Bordit të Apelit të DPPM sipas këtyre objekteve:

1. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave kombëtare

Gjatë vitit 2010, janë ndjekur procedurat dhe janë përpiluar njoftimet dhe aktet e tjera ligjore për **27 kërkesa** me objekt kundërshtimin e regjistrimit të markave të publikuar në Buletinin e Pronësisë Industriale të DPPM (aplikime kombëtare).

Kërkesat për kundërshtim marke, nga të cilat 20 janë paraqitur gjatë vitit 2009 dhe 7 gjatë vitit 2010, janë shqyrtuar nga Bordi dhe është marrë vendim prej tij gjatë vitit 2010 si më poshtë:

- 6 kërkesa janë pranuar, 1 është pranuar pjesërisht, 2 janë pushuar për shkak të heqjes dorë të aplikantit nga marka që kundërshtohet, 1 kërkesë nuk është pranuar për shqyrtim dhe 17 kërkesa janë refuzuar.

11 prej vendimeve të Bordit janë apeluar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Kërkesa për kundërshtimin e regjistrimit të markave ndërkombëtare

Gjatë vitit 2010, janë ndjekur procedurat dhe janë përpiluar njoftimet dhe aktet e tjera ligjore për 16 kërkesa me objekt kundërshtimin e regjistrimit të markave ndërkombëtare të publikuara në Buletinin e Markave të Zyrës Ndërkombëtare të WIPO (Organizata Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale).

Kërkesat për kundërshtimin e markave ndërkombëtare nga të cilat 1 është paraqitur në vitin 2008, 2 gjatë vitit 2009 dhe 13 gjatë vitit 2010, janë shqyrtuar nga Bordi dhe është marrë vendim prej tij gjatë vitit 2010 si më poshtë:

- 6 kërkesa janë refuzuar, 2 janë pranuar, 1 është pushuar për shkak të heqjes dorë të aplikantit nga marka që kundërshtohet dhe 7 janë ende në proces shqyrtimi nga Bordi. Janë apeluar në gjykatë 4 prej vendimeve të Bordit lidhur me këto kërkesa.

3. Kërkesa për apelimin e vendimit të DPPM për refuzimin e një aplikimi

Gjatë vitit 2010, janë ndjekur procedurat dhe janë përpiluar njoftimet dhe aktet e tjera ligjore për 6 kërkesa me objekt apelimin e vendimit të DPPM nga të cilat 5 kërkesa lidhur me refuzimin e një aplikimi për regjistrim ose ripërtëritje marke dhe 1 kërkesë lidhur me apelimin e vendimit të DPPM për refuzimin e rivendosjes së të drejtave mbi patentat.

Bordi i Apelit ka vendosur të refuzojë 5 nga kërkesat e mësipërme si të pabazuara në ligj dhe pranimin e 1 kërkesë për apelim. Vendimi i Bordit nuk është apeluar në gjykatë për asnjë prej rasteve të sipërcituara.

B. Përfaqësimi i DPPM në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2010, sektori juridik ka përfaqësuar DPPM në çështjet gjyqësore duke paraqitur kërkesa, shpjegime dhe prapsime për **20 çështje gjyqësore** nga të cilat: në 15 çështje DPPM është thirrur si palë e paditur dhe në 5 çështje është thirrur në cilësinë e personit të tretë.

Çështjet gjyqësore në të cilat DPPM është thirrur si palë e paditur ose si person i tretë ndahen sipas këtyre objekteve:

- Çështjet me objekt çregjistrim marke

Gjatë vitit 2010, janë ndjekur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 7 çështje me objekt shfuqizimin e markave të regjistruara, nga të cilat katër çështje janë akoma duke u shqyrtuar nga gjykata, 1 çështje është rrezuar dhe për dy prej tyre u vendos pushimi i gjykimit për arsye procedurale.

- Çështjet me objekt apelimin e vendimeve të Bordit lidhur me patentat

Gjatë vitit 2010, janë ndjekur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 4 çështje me objekt apelimin e vendimit të Bordit të Apelit të DPPM për lënien në fuqi të vendimit të Sektorit të Patentave për mospranimin e kërkesës për rivendosjen e të drejtave mbi patentat e shpikjes. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrezimin e dy prej padive, pushimin e njërës prej tyre dhe një çështje është akoma duke u shqyrtuar nga kjo gjykatë.

- Çështje me objekt shkeljen e të drejtave të pronësisë industriale:

Gjatë vitit 2010, është ndjekur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 1 çështje me objekt pushimin e shkeljes së të drejtave mbi markën e regjistruar dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar, çështje e cila është akoma në proces gjykimi.

- Çështje me objekt shfuqizimin e aktit administrativ:

Gjatë vitit 2010, janë ndjekur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 7 çështje me objekt shfuqizimin e vendimit të Bordit të Apelit të DPPM lidhur me kundërshtimet e palëve të treta për regjistrimin e markave tregtare, çështje të cilat janë duke u shqyrtuar nga gjykata.

- Çështje me objekt apelimin e vendimit për refuzim marke

Gjatë vitit 2010, është ndjekur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë 1 çështje me objekt shfuqizimin e vendimit të Sektorit të Markave të DPPM për refuzimin e aplikimit për regjistrim marke. Gjykata ka vendosur rrezimin e kërkesë-padisë, vendim i cili është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit.

C. Mbajtja e korrespondencës me Zyrën Ndërkombëtare të WIPO

Gjatë vitit 2010 janë dërguar pranë Zyrës Ndërkombëtare të WIPO (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale) njoftimet lidhur me regjistrimet ndërkombëtare si më poshtë:

- Njoftime për refuzimin e plotë provizor për shkak të paraqitjes së një kundërshtimi për 6 regjistrime ndërkombëtare;
- Njoftimi për konfirmimin e refuzimit të plotë provizor për 1 (një) regjistrim ndërkombëtar.

D. Marrëdhëniet me Jashtë dhe Trainimet

- Projektet me financim të huaj

Në kuadër të projektit IPA 2007 është hartuar Programi Rajonal për të Drejtat e Pronësisë Industriale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. DPPM është institucion përfitues nga ky program i cili ka si institucion implementues Zyrën Europiane të Patentave (EPO).

Implementimi i këtij programi filloi në Prill 2009 dhe përfundoi në Nëntor 2010.

Në zbatim të projekt-fishave të programit, janë arritur objektivat e mëposhtme:

- Ka përfunduar hartimi i Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale. Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale dhe Industriale është miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin Nr. 760 datë 01.09.2010.
- Janë përfunduar nga ekspertët e EPO në bashkëpunim me specialistët e DPPM broshurat dhe materialet informuese lidhur me Patentat, Markat, Disenjot Industriale.
- Ka përfunduar përkthimi i Klasifikimit Ndërkombëtar të Patentave, Klasifikimi i Locarnos dhe Klasifikimi i Nicës.
- Në kuadër të forcimit të infrastrukturës së IT së DPPM, ekspertë të EPO kanë bërë një vlerësim të sistemit të IT me qëllim dhënien e asistencës në projekte të ardhshme.

- Aktivitetet Trajnimi

Përfaqësues nga zyra juridike e DPPM kanë marrë pjesë dhe kanë paraqitur prezantime trajnuese në Seminarin me temë "Pronësia Intelektuale për Gjyqtarë, Prokurorë dhe Avokatë" organizuar nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale, Zyra Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe DPPM në datat 27-28 Tetor 2010.

i.Përgatitja e akteve ligjore në fushën e Pronësisë Industriale

- Gjatë muajit shtator 2010, me qëllim përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e pronësisë industriale dhe të praktikave të punës së DPPM, janë përgatitur draftet e ndryshimeve së bashku me relacionet shpjeguese për këto akte nënligjore: VKM Nr. 883 datë 13.05.2009 "Për miratimin e tarifave për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale", VKM Nr. 1707 datë 29.12.2008 "Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e

përdorimit”, Urdhërit Nr. 406 datë 06.05.2009 “Për miratimin e rregullores së brendshme të DPPM”.

- Gjatë muajit shtator 2010, në bashkëpunim me specialistët e Drejtorisë së Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, u hartua drafti final i Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis dy institucioneve, marrëveshje e cila u firmos dhe hyri në fuqi më datë 18.11.2010.

- Në bashkëpunim me Sektorin e Teknologjisë së Informacionit, është përgatitur marrëveshja e bashkëpunimit mes DPPM dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale (WIPO) dhe plani i veprimit për forcimin e infrastrukturës së IT dhe krijimin e Qendrave të Informacionit me asistencën e WIPO.

ii. Detyra te tjera te kryera nga sektori juridik

- Përgatitja e shkresave të ndryshme, raporteve dhe përkthimeve të ngarkuara nga Drejtori i Përgjithshëm.

- Përgatitja e materialeve në anglisht për faqen e internetit të DPPM si: legjislacioni në fushën e PI, formularët e aplikimit, tarifatat për paraqitjen e aplikimeve lidhur me markat, patentat, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, të reja dhe aktivitete.

- Kryerja në IPAS e veprimeve lidhur me aplikimet ndërkombëtare për regjistrimin e markave në bazë të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit;

- Shpërndarja e korrespondencës së DPPM me institucionet e tjera kombëtare, ndërkombëtare dhe me subjektet që aplikojnë pranë DPPM për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale.

4- SEKTORI I TEKNOLOGJISE SE INFORMACIONIT

Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka si objekt të veprimtarisë së tij administrimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së IT duke bërë të mundur administrimin e automatizimit të procedurave të regjistrimit të Objekteve të Pronësisë Industriale në DPPM. Ky sektor mundëson formatin elektronik të të gjithë objekteve të Pronësisë Industriale si edhe në zbatim të Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 dhe aktet nënligjore dalë në zbatim të tij, ky sektor bën të mundur përgatitjen e Buletinit të Pronësisë Industriale. Gjithashtu sektori harton politika për përmirësimin e infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit (TI) në DPPM.

Duke konsideruar rëndësinë që Teknologjia e Informacionit ka pasur dhe vazhdon të ketë në sistemin e Administratës Publike dhe nisma kombëtare për e-government, DPPM gjatë 2009 i kushtuar rëndësi përmirësimit të TI.

Gjatë vitit 2010 Sektori i Teknologjisë së Informacionit ka i ka realizuar detyrat e tij dhe angazhimet e mara në pikat e mëposhtme:

- 1) Hartimi i politikave për përmirësimin e infrastrukturës së TI në DPPM.
- 2) Implementimi i këtyre politikave dhe realizimi në ambientet e punës.
- 3) Administrimi dhe mirëmbajta e sistemit të TI në tërësi.
- 4) Kalimi i të dhënave në format elektronik.
- 5) Realizimi i publikimit të të gjithave Objekteve të Pronësisë Industriale në përputhje me bazën ligjore.

Në hartimin e politikave të përmirësimit të TI gjatë 2010 është bërë një studim i infrastrukturës për të parë pikat në të cilat ka qënë e domosdoshme përmirësimi

Një detyrë kryesore e sektorit të TI është edhe administrimi i sistemit të automatizimit të Pronësisë Industriale (IPAS).

Në Janar 2010 sistemi u konfigurua për procedimin e të gjithë vitit 2010, për arsye se sistemi funksionon me procedime vjetore, ku çdo ditë punë e vitit ka veprimet e bëra në këtë ditë.

Një element shumë i rëndësishëm gjatë vitit 2010 ka qënë edhe vazhdimi i konfigurimi i IPAS në përputhje me paketën e akteve nënligjore të re në zbatim të Ligjit 9947, dt. 07/07/2008, "Për Pronësinë Industriale".

Në Mars të 2009 u mundësua funksionimi i Modullit të Madridit. Ky modul është një komponent i sistemit IPAS për të dhënat e markave ndërkombëtare, të cilat aplikohen në territorin shqiptar në zbatim të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit. Ky modul u mundësua nga WIPO. Në bashkëpunim me WIPO sektori i TI mundësoi instalimin e tij dhe importimin në IPAS i 1200 rekordeve të markave të regjistruara në zbatim të Marrëveshjes dhe Protokollit të Madridit. Gjatë 2010 është vazhduar edhe kontrollimi i këtyre të dhënave gjithashtu ka vazhduar shkarkimi i vazhdueshëm i të dhënave për vitin 2010. Ky proces është një proces i kryer çdo javë për arsye se të dhënat mundësohen nga WIPO një herë në javë.

Sektori i TI është pikë kontakti i WIPO për instalimin e versioneve të përmirësuara të IPAS. Gjatë 2010 janë instaluar vazhdimisht versionet e reja të IPAS.

Ne kuader të rritjes së shërbimeve të ofruara nga DPPM sektori i TI ka pasur në fokus publikimin on line të të dhënave bibliografike të objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në Shqipëri. Për këtë qëllim ka hartuar planin për kërkesat drejtuar WIPO-s për të mundësuar këtë sistem. Gjatë 2010 sektori i TI mundësoi fillimisht publikimin e këtyre të

dhenave ne format xls dhe ne fokusin e 2011 eshte publikimi ne nje forme me te pershtatshme.

Sektori i TI në detyrat për funksionimin e IPAS gjatë 2010 ka kryer edhe:

- Ndryshimi, kur ka qene e domosdosshme e dokumenteve standarde që lëshon DPPM, formatimi i tyre bërja të mundur të shfaqjes së tyre në përdoruesit e këtij sistemi
- Back-up i përditshëm për sigurinë e ruajtjes së informacionit.
- Gjenerimi i statistikave të ndryshme gjatë 2010.
- Administrimi i të drejtave të secilit përdorues në përputhje më profilin e punës.
- Kalimi në IPAS i të dhënave bibliografike për 610 aplikime për marka, 341 aplikime për patenta, 6 aplikime për diseno industriale, 1 aplikim për tregues gjeografik. Lista e mallrave dhe shërbimeve për 272 aplikime për ripërtëritje marke, si edhe skanimin logove të markave dhe kalimin e tyre ne IPAS.

Nga sektori i TI në 2010 është bërë kontroll i përditshëm i sistemit të IT së DPPM i cili ka konsistuar në:

1. Rikonfigurimi 2 here i rrjetit te brenshem per arsye te ndryshimit te zyrave.
2. Administrim i rrjetit kompjuterik (LAN) dhe siguria e funksionim të këtij rrjeti dhe pajisjeve të instaluar në të.
3. Përditësim i faqes së internetit www.alpto.gov.al në varësi të informacioneve të dërguara nga sektorët përkatës.
4. Administrimin e mail serverit.
5. Ndihmë e stafit në përdorimin e bazës së të dhënave, dhe programeve të ndryshme në funksion të punës.
6. Është bërë e mundur instalimi dhe funksionimi i shërbimit të intserneti, nga 512Mbps në 1024Mbps.

PUBLIKIMI I BULETINIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE :

Sektori i TI bën të mundur përgatitjen e Buletinit të Pronësisë Industriale. Në vitin 2010 janë publikuar 2791 rekorde të ndara në 4 numra si më poshtë.

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 27, Dt. 12 Prill 2010

“Buletini i Pronësisë Industriale NR. 27, Dt. 12 Prill 2010 ne te cilin jane publikuar te dhenat bibliografike per 872 rekorde te Objekteve te Pronesise Industriale.

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 28, Dt. 08 Korrik 2010

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 28, Dt. 08 Korrik 2010 ne te cilin jane publikuar te dhenat bibliografike per 755 rekorde te Objekteve te Pronesise Industriale

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 29, Dt. 12 Tetor 2010

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 29, Dt.12 Tetor 2010 ne te cilin jane publikuar te dhenat bibliografike per 651 rekorde te Objekteve te Pronesise Industriale

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 30, Dt. 27 Dhjetor 2010

“Buletini i Pronësisë Industriale” NR. 30, Dt. 27 Dhjetor 2010 ne te cilin jane publikuar te dhenat bibliografike per 513 rekorde te Objekteve te Pronesise Industriale

Për përgatitjen e statistikave dhe raporteve sektori i TI ka realizuar si më poshtë:

- Përgatitjen raportit vjetor 2009 për sektorin e TI. Gjenerimin nga IPAS të të dhënave të domosdoshme për raportin vjetor 2009 të sektorëve të tjerë.
- Përgatitjen e statistikave të 2009- 2010.
- Përgatitjen e raporteve mujore për punën e sektorit të TI gjatë 2010, si edhe të të dhënave sektorëve të tjerë.
- Përgatitja e raporteve javore të punës së sektorit dhe gjenerimin e të dhënave për objektet e tjera të proçesuara.
- Formatimi i dokumenteve statistikore dhe dokumenteve të tjerë standarde.
- Përgatitjen e raporteve apo statistikave të ndryshme të kërkuara nga titullari.
- Përgjigje kërkesa të ndryshme të depozituara në DPPM të cilat kanë lidhje më sektorin e TI, dhe të deleguara nga titullari.

Detyra të tjera ndihmëse:

- Ka marë pjesë në takime qe kanë të bëjnë me TI.

- Ka organizuar dhe assituar plotesisht te misionin e WIPO ne lidhje me IPAS ne datat 4-7 tetor 2010.
- Ka ndihmuar në mbarëvajtjen e takimeve të organizuara nga DPPM.
- Ka bërë te mundur lëshimin e 1000 faturave për arkëtim.
- Ka përfaqësuar DPPM ne 2 Komitete Teknike dhe Operacional te EPO.
- Ka kontribuar në përgatitjen e Komenteve për Draft Strategjine.
- Ka kontribuar në përgatitjen e dhe kalimin on-line te PKZMSA.
- Janë hedhur në faqen e interentit materiale të dërguara nga sektorët e tjerë.
- Janë kryer të gjitha veprimet hyrje dalje me magazinën.
- Janë përgatitur përgjithë të shkresave të derguara që kanë lidhje më sektorin e IT.
- Ka kontribuar në përgatitjen e planit të buxhetit afatmesëm.
- Ka marrë pjesë në Seminarin Rajonal për Krimin në të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, ne Zagreb në datat 27-29 Prill 2010
- Në bashëpunim më Sektorin Juridik ka ndihmuar në mbylljen e procedurave të bordit të apelimit.
- Ka marrë pjesë në takimin e 4rt vjetor të vendeve anëtare të EPO, në datat 23-24 Qershor.
- Ka marrë pjesë bashke me pergjegjesen e sektorit Juridik ne Workshopin Rajonal per Konceptimin e Faqeve te Internetit te Zyrave te Pronesise Industriale, ne Shkup 28-29 Shtator 2010, per te cilin u pergatit dhe u referuar nje prezantim.
- Eshte angazhuar ne zhvendosjen e zyrave.

5. SEKTORI I BURIMEVE NJEREZORE, SHERBIMEVE DHE FINANCES

Si te gjitha institucionet e vendit edhe Drejtoria jone me sektoret perkates i eshte pergjigjur sfidave, qe jane shtruar para vendit tone per integrimin e tij ne BE. Si te gjithë sektoret e tjere edhe sektori i Burimeve Njerezore, Finances dhe Sherbimeve e ka konceptuar punen e vet ne permbushje te detyrave madhore qe lidhen me qasjen e DPPM-se ne analogji me DPPM-te homologe kryesisht ato ne rajon. Orientimet e ardhura nga Ministria e Ekonomise, Ministria e Integrimin dhe ajo e Finances kane qene udhëfyesi yne edhe ne sektorin e

ekonomik te kesaj drejtorie. Kjo u konkretizua ne percaktimin e produkteve dhe kostot per produkt te Strategjise Nacionale. Hapat e hedhura dhe pervoja e marre nga pjesemarrja ne takimet ne Komitetet e Perhershme ne EPO, si dhe komunikimet e vazhdueshme me kete institucion na kane ndihmuar ne menyre te konsiderueshme per te ridimensionuar punen tone ne menyre qe edhe sektori i i finances krahas sektoreve te tjere te profilizohet e te permbushe te gjitha detyrimet qe rrjedhin per DPPM si anetare e EPO. Drejtimet kryesore te veprimtarise se Sektorit te Burimeve Njerezore, Finances dhe Sherbimeve pergjate vitit kalendarik 2010 kane ardhur ne zbatim te detyrave qe ka ky sektor per te permbushur funksionin e tij brenda DPPM-se.

Keto drejtime jane:

1-Planifikimi dhe realizimi i buxhetit, 2-Bilanci, 3-Auditimi, 4-Marrdheniet me jashte ne sektorin ekonomik, 5 Organizimi I pritjeve te delegacioneve te huaja, 6 Ndjekja dhe rakordimi I te ardhurave nga EPO, WIPO si dhe nga aktiviteti kryesor I DPPM, te cilat jane pjese e Buxhetit te shtetit, 7 Kujdesi per shlyerjen e detyrimeve financiare qe rrjedhin nga anetaresimi ne WIPO dhe ne organizata te tjera nderkombetare , EPO etj, 8 Mbledhja e dokumentacionit perkates per personat e emeruar per here te pare ,si dhe largimin e personelit , ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Realizimi I buxhetit te vitit 2010 I shprehur ne shifra :

I Shpenzime personeli (Paga , shperblim, fondi I veçante)

Plan 13.500.000 lek Fakt 12.994.786 lek Realizimi 96 %

II Sigurim Shoqeror dhe Shendetesor

Plan 2.800.000 lek Fakt 2.018.313 lek Realizimi 72 %

III Shpenzime , sherbime te ndryshme

Plan 2.700.000 lek Fakt 2.690.659 lek Realizimi 99.9 %.


Duhet theksuar se mjaft sherbime te kryera gjate vitit 2010, per arsye te transferimit te zyrave te DPPM, do te likujdohen me fondet e vitit 2011. Eshte llogaritur kosto e ketyre shpenzimeve

.

Realizimi I Buxhetit ne total Plan 19.000.000lek Fakt 17.703.758 Realizimi 93 %

Te ardhurat nga aktiviteti kryesor për periudhën Janar - dhjetor 2010 arritën shumën 46.385.054 lekë. Të ardhurat dytësore nga aplikimet në EPO për periudhën Janar – Dhjetor 2010 arrijnë shumën 260.746 Euro. Këto të ardhura derdhen në buxhetin e shtetit.

Gjatë vitit 2010 janë depozituar në zyrën e protokollit 341 kërkesa për patentë sjpikje, 1851 kërkesa për mbajtje në fuqi, 38 ndryshime në pronësi, 36 ndryshime emri, 17 ndryshime adrese, 8 ndryshime në pretendime, 6 kërkesa për certifikata të mbrojtjes shtesë dhe 131 hetime patentash. Në zyrën e protokollit janë depozituar gjatë vitit 2010, 2395 dokumenta.



Grafiku i mësipërm tregon të ardhurat nga aktiviteti parësor i DPPM, dhe shpenzimet gjatë viteve 2001-2010.

IV- DETYRAT PER VITIN 2011

Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave ka përmbushur angazhimet e marra në kuadër të MSA për përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar në fushën e Pronësisë Industriale me acquis dhe ka realizuar të gjitha detyrat funksionale në ngarkim të saj gjatë vitit 2010.

Objektivat e DPPM janë përcaktuar saktësisht në strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale dhe industriale 2010-2015, miratuar me VKM nr.760 datë 01.09.2010.

Më poshtë po paraqesim objektivat e DPPM për vitin 2011:

1. DPPM do të realizojë të gjitha detyrat funksionale në ngarkim të saj që rrjedhin nga zbatimi i ligjit 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
2. Do të Administrojë të gjitha procedurat për dhënien dhe mbrojtjen e të drejtave të Pronësisë Industriale.
3. Gjatë 2011 në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me WIPO nënshkruar në tetor 2010 do të mundësohet instalimi i versionit të ri të sistemit IPAS, si dhe do të instalohet sistemi on-line për kërkimin e objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në Shqipëri.

4. Do të administrohet sistemi i automatizimit të PI (IPAS).
5. Projekti IPA 2009 parashikon në aktivitetet kryesore të tij disenjimin dhe suportin në krijimin e një sistemi të sigurt të IT për DPPM.
6. Projekti IPA 2009 parashikon në aktivitetet kryesore të tij zhvillimin e aktiviteteve promovuese për publikun.
7. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe organizatave të përfshira në sistemin e mbrojtjes së Pronësisë Industriale;

8. Gjatë vitit 2011 do të nënshkruhen marrëveshjet e bashkëpunimit mes DPPM dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë si dhe Unionit të Dhomave të Tregtisë.
9. Në bashkëpunim me institucionet si Shkolla e magjistraturës, Ministria e Drejtësisë etj, do të fillojë hartimi i kurrikulës së avancuar për magjistratët dhe prokurorët objektiv që do të zgjasë deri në vitin 2014.
10. Trajnimi i personelit të DPPM-së.
11. Projekti IPA 2009, projekt i cili do të implementohet gjatë periudhës 2011-2012 parashikon një plan veprimi me aktivitete zbatuese që kanë si qëllim forcimin e institucioneve të përfshira në mbrojtjen e te drejtave të Pronësisë Industriale si doganat, policia, gjykata nëpërmjet trajnimeve, asistencës në forcimin e infrastrukturës së IT.
12. Organizimi i trajnimeve që kanë për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të biznesit në lidhje me çështje të Pronësisë Industriale; rritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve zbatuese të legjislacionit të fushës, përfshirë sistemin gjyqësor.
13. Do të zbatohen plotësisht konventat e ratifikuara ndërkombëtare, për të drejtën e Pronësisë Industriale
14. Do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme faqja e internetit (www.alpto.gov.al), e cila për çështje sigurie do të vendoset në serverat e AKSHI-t.